

VENDIM
Nr.46, datë 16.1.2008

PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË SARANDË, TË PRONËS, E CILA ËSHTË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR, DHE DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.60, DATË 1.2.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 2 e 3 të nenit 42 të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, dhe të neneve 4, 5, 7 e 8 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi të bashkisë Sarandë të objektit me numër rendor 27, në formularin e inventarizimit të pronave të paluajtshme shtetërore “Qendra e shërbimeve për fëmijët 6-14 vjeç”, Sarandë, e cila është në përgjegjësi administrimi të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror.

2. Prona e përcaktuar në pikën 1, të hiqet nga lista e inventarit të pronave shtetërore, miratuar me vendimin nr.60, datë 1.2.2006 të Këshillit të Ministrave për miratimin e listës së inventarit të pronave shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Shërbimit Social Shtetëror”.

3. Institucioni i përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi dhe shërbimi shoqëror, që ofrohet në të, të transferohen së bashku me ndërtesën, fondet, pajisjet, inventarin, personelin dhe dokumentacionin përkatës.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2008, fondet e grupit 25, titulli 10430, kap.1, artikujt 600, 601 e 602, miratuar për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe, në vijim, sipas vitit buxhetor përkatës.

5. Bashkisë së Sarandës i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e përdorimit të pronës, tjetërsimin apo dhënien në përdorim të të tretëve.

6. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror, kryetari i bashkisë Sarandë dhe kryerregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha